



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 177

Tiranë – E enjte, 2 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Kryetarit të Kuvendit nr. 15, datë 1.10.2025	Për delegimin e kompetencave..... 22023
Dekret i Presidentit nr. 350, datë 1.10.2025	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore..... 22023
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Financave nr. 4, datë 12.9.2025	Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e Tunelit të Llogorasë nga përdoruesit e rrugës..... 22023
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 448, datë 22.9.2025	Për delegim kompetence..... 22024
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 920, datë 24.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë..... 22025
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 921, datë 24.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 22028
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 923, datë 25.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë..... 22029
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 924, datë 25.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar..... 22032

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 925, datë 25.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Argjentinës	22033
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 926, datë 25.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	22033
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 927, datë 25.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	22034
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 933, datë 26.9.2025	Për zbatimin e Rekomandimit (23-12) të ICCAT-it për ruajtjen e peshkaqenit balenë (<i>whale shark</i>) (<i>rhincodon typus</i>) të zënë gjatë aktivitetit të peshkimit në zonën e kompetencës së ICCAT-it.....	22036
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 934, datë 26.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	22038
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 935, datë 26.9.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Norvegjisë	22041
Vendim i Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 30.9.2025	Për zgjedhjen e z. Asim Vokshi anëtar të Gjykatës Kushtetuese.....	22041
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13686, datë 29.9.2025	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	22043
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13742, datë 30.9.2025	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	22043

**URDHËR**
Nr. 15, datë 1.10.2025**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Kuvendi i Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë:

a) Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj, për procedurat e prokurimit publik;

b) Në mungesë të z. Genci Gjonçaj, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.a, të këtij urdhri, delegohet znj. Merita Qato, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ, për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.

3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm në zbatim të këtij urdhri.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

DEKRET
Nr. 350, datë 1.10.2025**PËR CAKTIMIN E DATËS SË**
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME
VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE,
PËR DISA NJËSI TË QEVERISJES
VENDORE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe nenit 93, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 10, të ligjit nr. 10 019, datë

29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Caktimin e datës 9.11.2025, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore, për kryetar bashkie, për këto njësi të qeverisjes vendore:

1. Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë;
2. Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë;
3. Bashkia Berat, Qarku Berat;
4. Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë;
5. Bashkia Mat, Qarku Dibër;
6. Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4, datë 12.9.2025**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE**
PËR PËRDORIMIN E TUNELIT TË
LLOGORASË NGA PËRDORUESIT
E RRUGËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 223, pika 3, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 684, datë 6.11.2024, “Për krijimin e shoqërisë aksionare ‘Enti Kombëtar i Operimit Rrugor’ sh.a.” zëvendëskryeministri dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Tarifat që zbatohen për përdorimin e Tunelit të Llogorasë nga përdoruesit e rrugës, janë sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.



2. Tarifat me parapagim që zbatohen, për përdorimin e Tunelit të Llogorasë nga përdoruesit e rrugës do të përcaktohen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Lista e automjeteve dhe përdoruesve të përjashtuar nga zbatimi i tarifave sipas këtij udhëzimi, janë sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Ndalohen të përdorin Tunelin e Llogorasë mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme.

5. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Operimit Rrugor dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

SHTOJCA I TARIFAT PËR PËRDORIMIN E TUNELIT TË LLOGORASË

Automjetet	Çmimi në LEK me TVSH	Përshkrimi
Klasa I A; Mjete motorike me karakteristika motoçiklete, motorçikletë me tre rrota dhe katerçikletë	100	
Klasa I; Mjete motorike me dy boshthe dhe lartësi ≤1.30 m, e matur te boshhti i parë (makina pasagjerësh, automjete të lehta shpërndarjeje)	250	
Klasa II; Mjete motorike me më shumë se dy boshthe dhe lartësi ≤1.30 m, e matur te boshhti i parë, (makina pasagjerësh me rimorkio ose karavan, automjete të lehta shpërndarjeje me rimorkio ose karavan)	500	
Klasa III; Mjete motorike me dy ose tre boshthe dhe lartësi >1.30 m, e matur te boshhti i parë, përfshirë autobuzë, kamionë dhe mjete të ngjashme me rimorkio	1,000	
Klasa IV; Mjete motorike me katër ose më shumë boshthe dhe lartësi >1.30 m, e matur te boshhti i parë, përfshirë autobuzë dhe kamione me shumë rimorkio.	5,000	

SHTOJCA II

LISTA E AUTOMJETEVE DHE E PËRDORUESVE TË PËRJASHTUAR

1. Lista e përdoruesve të përjashtuar është si më poshtë:

- Automjetet e Policisë Rrugore;
- Autoambulancat;
- Automjetet e Forcave Zjarrfikëse;
- Automjetet Ushtarake, NATO;

d) Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889/1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, dhe përdorin automjete vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private, përjashtohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) Automjetet e personelit të ARRSH-së ose Entit të Operimit Rrugor, kur udhëtojnë për përmbushjen e detyrave funksionale, siç janë shërbimet e monitorimit, koordinimit, mirëmbajtja dhe operimi.

URDHËR

Nr. 448, datë 22.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si edhe t'i nënshkruajë ato.



Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Lavdrim Sahitaj, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

c) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

d) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

e) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

f) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

g) të ndjekë procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA), për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

h) të nënshkruajë aktet që rregullojnë marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë të ministrisë;

i) të nënshkruajë urdhrin për dërgimin me shërbim jashtë vendit, të punonjësve të institucioneve të varësisë;

j) të vlerësojë dhe miratojë kërkesat për transferimin e personelit mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor;

k) të vlerësojë dhe miratojë kërkesat për vazhdimin e marrëdhënies së punësimit, përtej moshës së përcaktuar për përfitimin e pensionit të pleqërisë, për personelin mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor;

l) të vlerësojë kërkesat për kontraktimin e përkohshëm të mjekëve jashtë organikës, në institucionet e kujdesit shëndetësor.

m) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca të ushtrohen nga z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 22.9.2025.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.

4. Ngarkohet z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 473, datë 4.9.2024, “Për delegim kompetence”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

URDHËR
Nr. 920, datë 24.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Grado*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Gorizia*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Mossa*



Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	San Pier d' Isonzo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Arzene*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Budoia*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Erto E Casso*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Frisanco*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Fontanafredda*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Maniago*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Vito d' Asio*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	San Giorgio Della Richinvelda*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	San Quirino*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Sequals*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Spilimbergo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Polcenigo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sopra*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sotto*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Travesio*
Friuli-Venezia Giulia	Trieste	Muggia*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Atimisi*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Arta Terme*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cassacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cividale Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Chiusaforte*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Comeglians*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Gemona Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paluzza*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ravascletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Raveo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Premariacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pontebba*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Nimis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Magnano In Riviera*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Malborghetto Valbruna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Moggio Udinese*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Prepotto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Grimacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paularo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pagnacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Artegna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Leonardo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Daniele Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Forgaria Nel Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Faedis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Savogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ragogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ovaro*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Taipana*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tricesimo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tolmezzo*
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Antey-Saint-André*
Valle d'Aosta	Aosta	Arvier*
Valle d'Aosta	Aosta	Arnad*
Valle d'Aosta	Aosta	Ayas*
Valle d'Aosta	Aosta	Aymavilles*
Valle d'Aosta	Aosta	Bard*
Valle d'Aosta	Aosta	Bionaz*
Valle d'Aosta	Aosta	Brissogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Brusson*
Valle d'Aosta	Aosta	Charvensod*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*

Valle d'Aosta	Aosta	Champorcher*
Valle d'Aosta	Aosta	Chamois*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Victor*
Valle d'Aosta	Aosta	Cogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Emarèse*
Valle d'Aosta	Aosta	Fénis*
Valle d'Aosta	Aosta	Fontainemore*
Valle d'Aosta	Aosta	Gignod*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressan*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressoney-Saint-Jean*
Valle d'Aosta	Aosta	Hône*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Pontey*
Valle d'Aosta	Aosta	Pollein*
Valle d'Aosta	Aosta	Roisin*
Valle d'Aosta	Aosta	Rhêmes-Saint-Georges*
Valle d'Aosta	Aosta	Nus*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Issogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Issime*
Valle d'Aosta	Aosta	La Salle*
Valle d'Aosta	Aosta	Jovençon*
Valle d'Aosta	Aosta	Lillianes*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Christophe*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Marcel*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Nicolas*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Vincent*
Valle d'Aosta	Aosta	Torgnon*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verres*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose



iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruara të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të

mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të



gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 893, datë 17.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 921, datë 24.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Dolnośląskie	Wolów	Wińsko*
Dolnośląskie	Zgorzelec	Węgliniec*
Warmińsko-Mazurskie	Lidzbark	Orneta*

Wielkopolskie	Czarnków-Trzcianka	Krzyż Wielkopolski*
Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Pyrzyce*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët.

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë stereotipave të demonstruar se janë të pranishëm në



popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve, ose;

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 887, datë 16.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 923, datë 25.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E KROACISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Bilje*	
Osjecko-Baranjska	Donji Miholjac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Jagodnjak*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Darda*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Vukovarsko-Srijemska	Gradište*	
Vukovarsko-Srijemska	Stari Jankovci*	
Vukovarsko-Srijemska	Trpinja*	
Vukovarsko-Srijemska	Zupanja*	
Vukovarsko-Srijemska	Otok*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pafektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të

paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;



c) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnavë në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të



derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 914, datë 22.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 924, datë 25.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E MBRETËRISË SË BASHKUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	Tiegnbridge*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Urdhri nr. 785, datë 12.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar



termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 925, datë 25.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ARGJENTINËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Argjentinës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
Buenos Aires	General Viamonte*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 926, datë 25.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BASHKUARA
TË AMERIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
South Dakota	South Dakota*
Kern	Kern*
Pennsylvania	Lancaster*
North Dakota	Dickey*
South Dakota	McPherson*
South Dakota	Beadle*
South Dakota	Faulk*
California	Los Angeles*
Arizona	Maricopa

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

5. Urdhri nr. 714, datë 24.7.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave

Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 927, datë 25.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;
- spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Baranya	Szigetvár*	
Borsod-Abaúj-Zemplén	Sátoraljaújhely*	
Somogy	Kadarkút*	
Veszprém	Tapolca*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:



i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët.

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë stereotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të

paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.



6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 909, datë 19.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 933, datë 26.9.2025

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMIT (23-12) TË ICCAT-it PËR RUAJTJEN E PESHKAQENIT BALENË (*WHALE SHARK*) (*RHINCODON TYPUS*) TË ZËNË GJATË AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË ZONËN E KOMPETENCËS SË ICCAT-it

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 8, pikat 1 dhe 2, të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut, të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT)”, dhe të nenit 25, pika 4, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e Rekomandimit (23-12) të ICCAT-it për ruajtjen e peshkaqenit balenë (*whale shark*) (*rhincodon typus*), të zënë gjatë aktivitetit të peshkimit në zonën e kompetencës së ICCAT-it.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, si dhe inspektorati përgjegjës për peshkimin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

**REKOMANDIMI (23-12) NGA ICCAT-i
PËR RUAJTJEN E PESHKAQENIT
BALENË (*WHALE SHARK*)
(*RHINCODON TYPUS*) TË ZËNË GJATË
AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË
ZONËN E KOMPETENCËS SË ICCAT-it**

duke vënë në dukje se neni 5 i Marrëveshjes së Kombeve të Bashkuara mbi Stoqet e Peshqve (UNFSA) i kërkon shteteve të flamurit të anijeve të peshkimit që shfrytëzojnë speciet shumë migratore të minimizojnë ndikimet mbi speciet e kapura rastësisht, të mbrojnë biodiversitetin detar dhe të mbledhin të dhëna përkatëse për hartimin e masave të duhura të ruajtjes dhe menaxhimit të bazuara në shkencë, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së këtyre specieve;

duke rikujtuar Rezolutën 77/118 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila, ndër të tjera, u kërkon shteteve dhe Organizatave Rajonale për Menaxhimin e Peshkimit (RFMOs), të forcojnë ose të krijojnë programe për mbledhjen e të dhënave, me qëllim marrjen e vlerësimeve të besueshme dhe të diferencuara sipas specieve për speciet e mbrojtura të kapura rastësisht gjatë peshkimit, si dhe të nxisin kërkime të mtejshme mbi përdorimin e masave të përshtatshme për zbutjen e zënien rastësore, si dhe të zbatojnë udhëzimet ndërkombëtare të FAO-s mbi menaxhimin e zënive rastësore dhe reduktimin e hedhjeve;



duke rikujtuar më tej se organizata të tjera rajonale për menaxhimin e peshkimit të tonit (p.sh., Rezoluta 13/05 e IOTC-së, Masa e Ruajtjes dhe Menaxhimit 2022-04 e WCPFC-së, dhe Rezoluta 19-06 e IATTC-së) kanë miratuar masa ruajtjeje për mbrojtjen e peshkaqenëve balenë nga ndërveprimet me aktivitetet e peshkimit që bien nën kompetencën e tyre;

duke vënë në dukje më tej se disa studime shkencore të paraqitura në SCRS gjatë viteve të fundit kanë treguar se peshkimet në kuadër të ICCAT-it, ato që përdorin koshilok ose rrjeta me rrethim (*purse seine*), ndërveprojnë me peshkaqenët balenë, dhe se disa flota që përdorin rrjeta me rrethim në zonën e Konventës së ICCAT-it tashmë zbatojnë në mënyrë vullnetare praktikat dhe procedurat më të mira ekzistuese për mbrojtjen e peshkaqenëve balenë;

duke njohur më tej se SCRS-ja më parë ka këshilluar se “Masa të menaxhimit me karakter paraprak duhet të merren në konsideratë për stoqet ku ekziston cenueshmëria biologjike më e madhe dhe shqetësim i lartë për ruajtjen, dhe për të cilat ekzistojnë shumë pak të dhëna”, çka mund të aplikohet në mënyrë të arsyeshme edhe për peshkaqenët balenë;

duke vënë në dukje se në rishikimin e tij të dytë të performancës, në kapitullin “Tendencat në statusin e specieve joobjektive”, Paneli i Rishikimit ka rekomanduar që “qëndrimi paraprak (*precautionary approach*) të aplikohet në mënyrë të qëndrueshme për speciet e lidhura, duke marrë parasysh se vlerësimet për këto specie janë shumë të pasigurta dhe se statusi i tyre shpesh është pak i njohur”.

KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR RUAJTJEN E TONIT NË ATLANTIK (ICCAT), REKOMANDON SI MË POSHTË, SE:

1. Nuk lejohet mbajtja në bord, transbordimi ose zbarkimi, i plotë ose i pjesshëm, i çdo ekzemplari të peshkaqenit balenë (*rhincodon typus*) të zënë në peshkimet që bien nën juridiksionin e ICCAT-it.

2. Ndalohej hedhja e rrjetave të tipit “koshilok” mbi tufa të peshkut ton të cilat midis tyre vihet re përpara fillimit të hedhjes së rrjetës dhe peshkaqeni balenë.

3. Në rast se një peshkaqen balenë përfshihet aksidentalisht brenda rrjetës së koshilokut, kapiteni i mjetit të peshkimit merr të gjitha masat e arsyeshme për lirim të tij të sigurt.

4. “Deri në miratimin e udhëzimeve për trajtimin dhe lirim të sigurt, sipas përcaktimeve të paragrafit 9 më poshtë, Palët Kontraktuese (CPCs) duhet të

kërkojnë nga kapitenët e mjeteve të tyre me flamur përkatës që, duke marrë masat e nevojshme për të siguruar trajtimin dhe lirim të sigurt të peshkaqenit balenë, siç parashikohet në paragrafin 3, dhe duke garantuar njëkohësisht sigurinë e ekuipazhit, të zbatojnë udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1.”.

5. “Palët Kontraktuese (CPCs) sigurojnë që, në përputhje me kërkesat e Rekomandimit të ICCAT-it për vendosjen e standardeve minimale për programet e vëzhguesve shkencorë në mjetet e peshkimit (rec. 16-14), ndërveprimet me peshkaqenin balenë gjatë operacioneve me rrjetë *purse seine* të regjistronen nëpërmjet programeve të tyre kombëtare të vëzhguesve.

Gjithashtu, dubet të mbledhen këto të dhëna:

i. detaje mbi mënyrën dhe arsyen e përfshirjes së kafshës në rrjetë;

ii. numri i individëve të përfshirë gjatë ndërveprimit;

iii. vendndodhja e ndërveprimit;

iv. hapat e ndërmarrë për të siguruar trajtimin dhe lirim të sigurt të ekzemplarëve të përfshirë në rrjetën *purse seine*, dhe

v. një vlerësim i gjendjes së ekzemplarëve të peshkaqenit balenë në momentin e lirim (i gjallë /i ngordhur/në gjendje të rëndë/i pasigurt)”.

6. “Palët Kontraktuese (CPCs) raportojnë të dhënat dhe informacionin e mbledhur sipas paragrafit 5 në raportet e tyre vjetore dhe, në rastin e të dhënave të mbledhura përmes programeve të vëzhguesve, ia paraqesin sekretariatit në përputhje me kërkesat e ICCAT-it për raportimin e të dhënave”.

7 “Paragrafët 1–6 nuk zbatohen për mjetet e peshkimit që operojnë ekskluzivisht në veri të paralelit 40° N ose në jug të paralelit 40° S (d.m.th. jashtë diapazonit kryesor gjeografik të peshkaqenit balenë në Oqeanin Atlantik)”.

8. “Komiteti Shkencor për Kërkime dhe Statistika (SCRS), në vitin 2024, do të shqyrtojë të dhënat dhe informacionin ekzistues që lidhen me ciklin jetësor dhe statusin e ruajtjes së peshkaqenit balenë, dhe do të konfirmojë nëse ky i fundit përmbush përkuftizimin e një taksoni me cenueshmërinë biologjike më të lartë dhe shqetësim për ruajtjen, për të cilin ka shumë pak të dhëna. Nëse kjo do të jetë e vërtetë, SCRS-ja do të japë këshillë mbi përshtatshmërinë e zbatimit të masave të kujdesshme të menaxhimit në peshkimet e ICCAT-it, si p.sh. një ndalim i mbajtjes. SCRS-ja, gjithashtu, mund të identifikojë opsione për kërkime dhe



mbledhje të dhënash në të ardhmen, si dhe të japë këshilla mbi masa të tjera zbutëse për peshkimet përkatëse të ICCAT-it”.

9. “Komisioni fton SCRS-n që, në momentin më të përshtatshëm, të shqyrtojë dhe të miratojë kufijtë gjeografikë të përcaktuar në paragrafin 7 dhe udhëzimet për lirim të sigurt të peshkaqenëve balenë të përfshirë në rrjetë, siç janë parashikuar në aneksin 1, duke marrë parasysh ato të zhvilluara në RFMOs të tjera”.

10 “Duke vënë në dukje se efektiviteti i metodave të ndryshme të lirimit ende duhet të vlerësohet, Palët Kontraktuese (CPCs) inkurajohen të ndërmarrin aktivitete kërkimore mbi praktikën e trajtimit dhe lirimit, duke siguruar shkallë të lartë mbijetese pas lirimit për peshkaqenët balenë të kapur aksidentalisht gjatë operacioneve me rrjetë *purse seine*”.

11. “Pavarësisht nga neni VIII i Konventës së ICCAT-it, Palët Kontraktuese (CPCs) do të zbatojnë këtë Rekomandim jo më vonë se 1 janari 2025, me kusht që të përmbushen temat e përcaktuara në paragrafin 12”.

12. “Vetëm nëse arrihet një konsensus mbi interpretimin e këshillës së SCRS-së në mbledhjen vjetore të komisionit të vitit 2024, ky Rekomandim do të hyjë në fuqi sipas afatit të përcaktuar në paragrafin 11”.

ANEKS I

Udhëzime për trajtimin dhe lirim të sigurt të peshkaqenit balenë

Pika 1 – Praktikën e rekomanduara

- Përdorimi i rrjetës “*sail brail*” ose të një rrjete të vogël (*dip net*) për ngritjen dhe lirim të ekzemplarëve më të vegjël se 2 metra, duke i lëshuar direkt në det pa i vendosur mbi bord;

- Ulja e litarit të notuesve (*cork line*) në mënyrë që peshkaqeni balenë të rrokulliset jashtë rrjetës. Nëse individ nuk del vetë, vendoset një litar poshtë trupit dhe lidhet me vijën e notuesve për ta ndihmuar të dalë;

- Prerja e disa metrave të rrjetës përpara peshkaqenit balenë, me qëllim lirim të tij.

Pika 2 – Praktikën që duhen shmangur

- Ngritja e peshkaqenëve nga bishti;

- Tërheqja e tyre me litarë të lidhur rreth gushës ose me vrma të bëra në pendë;

- Përdorimi i grepave metalikë (*gaffing*);

- Lënia e litarëve tërheqës të lidhur rreth trungut të trupit;

- Përdorimi i rrjetës “*brail*” për individë më të mëdhenj se 2 metra;

- Ngjitja e peshkaqenëve mbi kuvertë përmes *brailimit*;

- Fillimi i procesit të *brailimit* ndërkohë që peshkaqeni balenë ndodhet ende brenda rrjetës *purse seine*.

URDHËR

Nr. 934, datë 26.9.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Osjecko-Baranjska	Bilje*	
Osjecko-Baranjska	Donji Miholjac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Jagodnjak*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Darda*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Čeminac*	
Vukovarsko-Srijemska	Gradište*	
Vukovarsko-Srijemska	Stari Jankovci*	
Vukovarsko-Srijemska	Trpinja*	



Vukovarsko-Srijemska	Županja*	
Vukovarsko-Srijemska	Otok*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar



dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të

derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 923, datë 25.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Kroacisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.



6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 935, datë 26.9.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E NORVEGJISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe e tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Norvegjisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
Nordland	Hadsel*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 2, datë 30.9.2025

**PËR ZGJEDHJEN E Z. ASIM VOKSHI
ANËTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

- | | |
|------------------|----------|
| 1. Sokol Sadushi | kryetar; |
| 2. Ilir Panda | anëtar; |
| 3. Ervin Pupe | anëtar; |
| 4. Medi Bici | anëtar; |



5. Sokol Binaj	anëtar;
6. Albana Boksi	anëtare;
7. Sandër Simoni	anëtar;
8. Artur Kalaja	anëtar;
9. Arbena Ahmeti	anëtare;
10. Margarita Buhali	anëtare;
11. Gentian Medja	anëtar;
12. Sokol Ngresi	anëtar;
13. Enton Dhimitri	anëtar;
14. Enkelejda Metaliaj (Softa)	anëtare;
15. Valbon Çekrezi	anëtar,

Në mbledhjen e datës 30.9.2025, e cila ka në rend të ditës zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, që është në emërtesë të saj,

VËREN:

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj, që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit shpalli në datën 11.12.2024 thirrjen e shprehjes së interesit për të kandiduar në këtë pozicion.

3. Lista e kandidatëve që aplikuan së bashku me dokumentacionin shoqërues iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organi që kryen verifikimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të kandidaturave, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 23.9.2025, depozitoi në Gjykatën e Lartë listën e renditjes së kandidatëve së bashku me raportin e renditjes së kandidatëve dhe dokumentacionin përkatës. Në listën e renditjes së kandidatëve, z. Asim Vokshi është renditur i pari me 89.5 pikë, znj. Naureda Llagami është renditur e dyta me 89.3 pikë, ndërsa z. Florian Ballhysa është renditur i tretë me 77.83 pikë.

5. Me vendimin nr. 1, datë 25.9.2025, kryetari i Gjykatës së Lartë vendosi thirrjen e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese më datë 30.9.2025.

6. Mbi bazën e vendimit nr. 1, datë 24.2.2022, “Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të

Gjykatës Kushtetuese”, si dhe referuar listës së kandidatëve dhe renditjes së tyre nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. 220, datë 25.9.2025, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me kandidatët: Asim Vokshi, Naureda Llagami dhe Florian Ballhysa, sipas renditjes së përcaktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

7. Më datë 30.9.2025, u zhvillua Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku morën pjesë 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke plotësuar kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë Asim Vokshi, për shkak se është në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mori pjesë në mbledhje, ndërsa gjyqtarja Vojsava Kola nuk mori pjesë për arsye shëndetësore.

8. Referuar Rregullores së Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, procesi i votimit u administrua nga komisioni i posaçëm i votimit, i miratuar për këtë qëllim nga Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve, në përbërje të të cilit janë: kancelari i Gjykatës së Lartë, kryesekretari dhe një sekretar gjyqësor.

9. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni, pas numërimit të fletëve të votimit, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët: z. Asim Vokshi mori 6 (gjashtë) vota, znj. Naureda Llagami mori 8 (tetë) vota, z. Florian Ballhysa nuk mori 0 (zero) votë, ndërsa 1 (një) votë u shpall e pavlefshme.

10. Referuar nenit 7/ç, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili parashikon se kandidati fitues duhet të sigurojë një shumicë prej 3/5 të votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe, në kushtet kur asnjëri prej kandidatëve nuk arrin të sigurojë shumicën e votave të nevojshme, kandidati që është i pari në listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të hartuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, konsiderohet *ipso lege* i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.



PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 125, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 7/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në rezultatet e votimit të zhvilluar në datën 30.9.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e z. Asim Vokshi anëtar të Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9-vjeçar.
2. Ky vendim i dërgohet kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
3. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Kryetar: Sokol Sadushi

Anëtarë: Artur Kalaja, Ilir Panda, Albana Boksi, Sokol Binaj, Ervin Pupe, Medi Bici, Sokol Ngresi, Sandër Simoni, Gentian Medja, Enton Dhimitri, Arbena Ahmeti, Margarita Buhali, Enkelejda Metaliaj (Softa), Valbon Çekrezi

NJOFTIM

Nr. 13686, datë 29.9.2025

**PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

“Aneksi XV për Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (WIPO)”, bërë në Gjenevë, më 4.10.1977, i Konventës për Imunitetet dhe Privilegjet e Agjencive të Specializuara, bërë në Nju-Jork, më 21.11.1947, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë në datën 2 shtator 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

NJOFTIM

Nr. 13742, datë 30.9.2025

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen e së drejtës së ushtrimit të profesioneve të avokatit dhe ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, nënshkruar më 6.7.2023, hynë në fuqi më 24 shtator 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 96 lekë